



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 34

Prishtinë, më 25.01.2016 në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Ilir Deda, Luljeta Veselaj- Gutaj, Vjosa Osmani, Arben Gashi, Kujtim Paqaku.

Munguan: Xhavit Haliti, Rustem Mustafa, Valdete Bajrami, Slobodan Petroviq dhe Time Kadrijaj.

I ftuar: Ministri i Integritetit Evropian, z. Bekim Çollaku.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Ahter Loxha, Adelina Demolli dhe Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

Miratimi i rendit të ditës;

Raportim i z. Bekim Çollaku, ministër i Integritetit Evropian, lidhur me plotësimin e tetë rekomandimeve për liberalizimin e vizave;

Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Teuta Sahatqija, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Kryetarja falënderoi ministrin për gatishmërinë e tij të përhershme që të vijë në Komisionin për Integritet Evropian.

Procesi i integrimi është kompleks dhe ka kërkuar angazhim të gjithanshëm dhe afatgjatë. Viti 2015, shënoi përfundimin e një procesi të gjatë, por të suksesshëm lidhur me MSA-në, përmes ratifikimit në Kuvendin e Kosovës dhe e përcjellë me votimin në Parlamentin Evropian. Presim që së shpejti të kryhen të gjitha procedurat dhe MSA-ja të fillojë zbatimin e saj, prej së cilës do të përfitojnë, në radhë të parë, qytetarët e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, na keni informuar që 8 kriteret e mbetura për liberalizimin e vizave që dolën në momentin e fundit, duhet të plotësohen ende. Ju ministër na e keni dërguar një raport, ku shihet progresi i dukshëm dhe përmbushja e 8 kriterëve . Qëllimi i ftesës është që ta informoni Komisionin lidhur me këtë proces dhe të bashkëbisedojmë lidhur me ngritjen e përgjegjësi të këtij Komisioni me plotësimin e MSA-së.

Ministri Bekim Çollaku, falënderoi Komisionin për ftesën dhe mbështetjen e Komisionit që po i jep këtij procesi në vazhdimësi. Ashtu siç jeni në dijeni, në raportin e fundit të Komisionit Evropian, të dalë në dhjetor, nga 95 kriteret sa i përmban udhërrëfyti për liberalizimin e vizave, 87 kanë qenë të plotësuara, ndërsa 8 kriteret janë konsideruar si të plotësuara pjesërisht dhe për këto janë dhënë udhëzime shtesë sesi të veprohet,

në mënyrë që ato të adresohen në tërësi. Personalisht dhe si ministri e integritetit evropian që e koordinojmë këtë proces në emër të institucioneve të republikës së Kosovës nuk kam qenë i kënaqur me raportin e publikuar nga Komisioni Evropian, sepse kemi konsideruar se disa nga punët e mëdha që janë bërë muajt e fundit nuk kanë qenë të pasqyruar saktë në këtë raport, sepse nuk kemi pasur komision vlerësues, që nga korriku i vitit të kaluar dhe raporti është hartuar shumë më herët se kur është publikuar.

Në anën tjetër, kjo mund të konsiderohet si element pozitiv, se kemi qenë më të përgatitur, që në mënyrë të tërësishme, t'i adresojmë këto 8 rekomandime nga raporti i fundit nga Komisioni Evropian. Pa u publikuar raporti, nuk mund të ndodhë edhe rekomandimi për liberalizimin e vizave, por rekomandimi nuk do të vonojë shumë dhe po flasim për pak javë, që kjo të ndodhë. Javën e kaluar kemi dërguar inputin e fundit për përmbushjen e këtyre 8 rekomandimeve dhe ende është në proces të vlerësimit të brendshëm nga ana e Komisionit. Presim që Komisioni të veprojë shpejt, pa humbur kohë dhe do ta verifikojë përmbushjen e këtyre rekomandimeve. Kjo do të ndodhë gjatë pjesës së parë të muajit shkurt dhe do t'i paraprijë vizitës së komisionarit Avramulos gjatë shkurtit dhe do të kurorëzohet me përfundimin se Kosova i ka përmbushur 8 rekomandimet që kanë dalë në raportin e fundit për liberalizimin e vizave.

Element pozitiv është që Kosova vazhdon të trajtohet me të njëjtën pako me dy shtete tjera që presin të marrin rekomandimin për liberalizimin e vizave, që janë Gjeorgjia dhe Ukraina. Përkundër krizës së madhe të refugjatëve, me të cilën ballafaqohet BE-ja , mendoj që në rastin e Kosovës dhe dy shteteve të lartpërmendura ka vullnet të mjaftueshëm politik për liberalizimin e vizave. Në vazhdim, iu tha anëtarëve nëse konsideroni se duhet të sqarohen një nga një kriteret, mund të fillojmë, por për të mos humbur kohë shumë, mund të parashtroni pyetje për ato kriteret që mendoni se janë më të ndjeshme.

Kryetarija e konsideroi raportin si të mirë, sepse secili kriter është shpjeguar me hollësi, përmes tabelave, ku paraqiten shënime për përmbushjen e kriterëve, në vazhdim hapi diskutimin.

Arben Gashi, pyeti se çka ndodhi që kryeministri dhe zv.kryeministri dolën me deklarata proteste ndaj BE-së. Ku ndodhi keqkomunikimi apo keqkuptimi pas publikimit të raportit?

Ministri, tha se nuk ka pasur asnjë lloj keqkomunikimi, sepse çdo deklaratë që është e karakterit politik nga Zyra e Kryeministrit dhe Zëvendëskryeministrit ose nga unë, ose dikush tjetër, për këtë çështje specifike, çdo gjë është e koordinuar dhe asgjë nuk bëhet ad-hok. Deklaratave që iu referoheni, kanë ndodhur para publikimit të raportit dhe indikacionet tona kanë qenë se mund të ketë tendenca që ky raport i publikuar në dhjetor, mos të konsiderohet i fundit, ndërsa kritikant tona kanë qenë, pikërisht për të parandaluar një gjë të tillë. Deklaratat nuk kanë qenë për t'i

prishur marrëdhëniet me BE-në, por thirrje e ndërgjegjes, që mos të zvarritet ky proces në pafundësi. Efekti është arritur dhe gjithçka është në rregull tani.

Arben Gashi, ju keni reaguar zyrtarisht dhe publikisht për një informacion jozyrtar dhe jo-publik.

Ministri tha se nëse raporti do të publikohej dhe nuk do të ishte i fundit, atëherë do të ishte shumë vonë për çfarëdo deklarate, dhe sa herë që ka nevojë për të preventuar ndonjë gjë, ne e bëjmë pa asnjë hezitim.

Arben Gashi, tha se e di që gjithsesi Kosova ka kaluar nëpër proces të veçantë dhe mendoj se MSA-ja dhe raporti për liberalizim të vizave janë lajme të mira, për të cilat duhet punuar bashkërisht edhe si Kuvend, si dhe duhet përdorur edhe më tepër diplomacia parlamentare, në mënyrë që të krijohet një perceptim tjetër nga Kuvendi, sepse si Kuvend dhe nuk besoj se asnjë parti, pozitë apo opozitë, kur shkon në Bruksel, do të japë mesazh të keq për Kosovën. Mendoj se ky instrument duhet përdor më shumë në interes të vendit.

Kryetarja, theksoi se këto 8 kritere janë si dy grupe të kriterëve dhe grupi i parë ka të bëjë me tepër me gjykata, me organin e prokurimit dhe zbatimin e amendamentimin e legjislacionit sekondar. Grupi tjetër ka të bëjë me riintegrim, azilkërkues, por edhe pavarësia buxhetore dhe zyrat e Avokatit të Popullit, të cilat Gjykata Kushtetuese nuk është duke i lëshuar, ndërsa demarkacioni me Malin e Zi dhe ratifikimi është ende në pritje në grupin e dytë.

Ilir Deda, në diskutimin e tij u përqendrua në 3 rrafshë të ndryshme.

1. A do të thotë që pasi kryeministri ka vendosur që do të udhëtojë në Bruksel po bëhet liberalizimi?
2. Nuk është ideja që ne të jemi në paketë së bashku me Gjeorgjinë dhe Ukrainën, me rekomandimin pozitiv të Komisionit Evropian.
3. Ne e dimë që e gjitha nuk varet prej Komisionit Evropian, por edhe prej grupit të shteteve të cilat e kanë njohur Kosovën dhe të cilat janë skeptike për liberalizimin e vizave për qytetarët tonë. Do të ishte mirë që të bëhej një plan i përbashkët për vizitat në 4 kryeqytetet kyçe, sepse ne nuk mund të rrimë dhe te presim të kryhet ajo pjesë e punëve tona, pa marrë parasysh a shkojmë në zgjedhje apo jo në pranverë. Në fund, pyeti se çka do të bëhet me refuzimin e Gjykatës Kushtetuese, sepse nuk është reflektuar në raportin që na e keni dorëzuar.

Ministri, sa i përket pyetjes së parë, lidhur me deklaratën e kryeministrit, pra asaj që duket si kushtëzim i ministrit, si anëtar i kabinetit nuk më takon t'i komentoj deklaratat e ministrit, por personalisht mendoj se përmes kësaj deklarate t'i dërgohet një mesazh i qartë i BE-së, që mos të zvarritet ky proces në pafundësi, dhe njëkohësisht, tregon një dozë më të madhe solidariteti me qytetarët e Kosovës. Prej fillimit të dialogut në Bruksel, deri më sot, nuk ka qenë me kushtëzime, sepse në momentin që ka kushtëzim, nuk ka dialog. Dialogu do të vazhdojë dhe takimi i radhës do të realizohet gjatë kësaj jave, ashtu si ka qenë i planifikuar

Kurse sa i përket asaj që a po pretendojmë të jemi në pako me dy shtetet tjera, ne jemi në të njëjtën pako me Gjeorgjinë, që llogaritet që ka më progres se Kosova dhe Ukrainën që nuk ka bërë progres as sa Kosova, as sa Gjeorgjia, por për shkaqe politike dhe gjeostrategjike, konsiderohet si një vend i rëndësishëm, i cili duhet të përfitojë dhe rekomandimi pritët të jepet në të njëjtën kohë, për të tri shtetet. Kurse sa i përket çështjes së ndërtesës së Avokatit të Popullit, është një çështje që ende nuk është adresuar dhe ende nuk është plotësuar si kriter dhe nuk kemi një ndërtesë fikse për nevojat që i duhen Avokatit të Popullit, dhe opsioni më i mirë ka qenë, lëvizja e Gjykatës Kushtetuese në Pallatin e Drejtësisë, por sipas deklarimeve që i keni dëgjuar nuk do të preferonin të zhvendosen nga objekti ku janë.

Lidhur me bashkërendimin e aktiviteteve është shumë e rëndësishme, sepse rekomandimi do të jetë nga ana Komisionit Evropian kurse vendimi do të jetë nga ana e Këshillit, kurse Këshilli po

të dojë mund të nxjerr kërkesa tjera kundra Komisionit pas dhënies së rekomandimit , unë jam plotësisht i hapur dhe do të bëjë çmos që të aranzhojmë vizita dhe ti bëjmë të përbashkëta.

Kujtim Paqaku, pyeti ministrin se në raportet e mëhershme si e keni paraqitur komunitetin rom në suazat e Avokatit të Popullit , sepse e di që ka shumë lëndë të pazgjedhura kur është në pyetje komuniteti rom dhe komuniteti rom është më i diskriminuar, si te punësimi, uzurpimi i pronave etj.

Ministri, së pari shprehu mirëkuptimin për interesimin e deputetit për komunitetin që e përfaqëson, mirëpo e dini se Kosova është shtet i pavarur dhe demokratik, të gjitha komunitetet janë të barabarta para ligjit, si dhe në përfitimet brenda sistemit që veprojnë. Asnjëherë nuk raportoj në Komisionin Evropian në mënyrë të veçantë për ndonjë komunitet të caktuar, por raportoj për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Kur është në pyetje shkelja eventuale e të drejtave të njeriut apo të ndonjë komuniteti, atëherë raportojnë institucionet përkatëse, si Avokati i Popullit që bën raporte dhe merret me shkeljet eventuale. Jam në dijeni për vështirësitë e komunitetit rom dhe ju mund t'i ftoni ata që janë përgjegjës për implementimin e strategjisë qeveritare, që t'ju raportojnë se çka po bëhet në zbatimin e asaj strategjie në praktikë për integrimin e komunitetit rom, mirëpo ne nuk bëjmë raporte ekskluzive për komunitete të caktuara.

Sa i përket fondit për riatdhësim dhe riintegrim, çdokush ka të drejtë të përfitojë nga ai fond, nëse i plotëson kriteret e përcaktuara nga rregulloret në fuqi, por për informimin tuaj, ai fond vitin e kaluar është shpenzuar vetëm 52%, e që është për keqardhje. Pra, ose ka probleme tek kriteret, ose tek vetëdijësimi i qytetarëve për mundësinë e përfitimit nga ai fond, ose kur ata të kthehen, nuk kanë nevojë të asaj natyre. Para dy javësh, kemi pasur një takim me përfaqësuesit e komunave dhe u kemi thënë që të punojnë më tepër me ata që kthehen, për mënyrat se si mund të përfitojnë nga ky fond, sepse mënyrat e përfitimit janë të ndryshme, si nga mundësia e përfitimit të ndonjë vendi të punës, përfitimit të kulmit mbi kokë dhe mundësi tjera trajnimi dhe shkollimi.

Kryetarja kërkoi nga ministri, pasi që janë mediat prezent, që në fund të njoftojë lidhur me transferimin e gjykatësve për krime të rënda, në të gjitha gjykatat e Kosovës, për rastet e korrupsionit, krijimit të regjistrave të hetimit, ndihmës së formës së prerë të gjykatave, konfiskimin e pasurisë, në mënyrë që qytetarët të njoftohen nëpërmjet mediave.

Vjosa Osmani, tha se pak para se të publikohet raporti dhe menjëherë pas publikimit të tij, kemi dëgjuar deklaramë nga disa anëtarë të kabinetit qeveritar, ku thuhej se Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret, por ky raport e demanton këtë kur i shikojmë vetëm datat, por nëse nuk kanë qenë këto kritere edhe më herët, atëherë duhet të sqarohen.

Në vazhdim, i tha ministrit se ju e thatë me të drejtë se gjithçka nuk përfundon tek rekomandimi i Komisionit Evropian, por sfida më e madhe do të jetë se çka do të thonë shtetet anëtare, më konkretisht, ministrat e punëve të brendshme, dhe siç e dini, për ta çështja kryesore që analizohet është migrimi dhe nga viti paraprak, që ende nuk dihet shifra konkrete, ku me mijëra qytetarë janë larguar nga Kosova, andaj pyeti se sa po punohet me shtetet anëtare. Para pak ditësh kishim takim me Grupin e Miqësisë të deputetëve të Austrisë. Kërkesa ime konkrete ishte që ata të punojnë me ministrin e tyre të brendshëm, por edhe me shtetet tjera, që ata mund të kenë raporte të mira, që kur të vijë çështja në Këshill, të kemi një po nga ana e këtyre shteteve.

Sa i përket kritereve konkrete, ju në këtë raport e keni përfshirë çështjen e ratifikimit të marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi, a mund të na sqaroni se çka saktësisht pritet të bëhet nga ana e institucioneve të Kosovës, para se të jepet rekomandimi, dhe nëse rekomandimi bëhet pozitiv, a mendoni se Këshilli mund të nxjerrë probleme lidhur me dhënien e dritës së gjelbër përfundimisht, në qoftë se nuk e kemi marrëveshjen e ratifikuar, para se kjo çështje të trajtohet në Këshill?

Më duhet ta them se çështja e ndërtesës për Avokatin e Popullit nuk është një çështje teknike. Pavarësia e një institucioni në ditët e sotme, nuk sigurohet vetëm duke eliminuar ndërhyrjen e

drejtpërdrejtë politike, por duke siguruar pavarësi buxhetore dhe fizike, që nënkupton pavarësinë në ndërtesa, aq sa i duhet një pavarësi e tillë Institucionit të Avokatit të Popullit. aq më shumë i duhet Gjykatës Kushtetuese dhe kushdo që thotë se Gjykata Kushtetuese është pjesë e gjyqësorit, duhet ta lexojë Kushtetutën, sepse Gjykata Kushtetuese është institucion plotësisht i ndarë që e interpreton Kushtetutën dhe po e shoh aq gabim që të jetë në të njëjtën ndërtesë me gjykatat e tjera të rregullta të Kosovës, duke e ditur që në baza ditore, analizon dhe jep vendime për vendimet e po këtyre gjykatave. Prandaj, unë mendoj që në vend të insistimit që ata të largohen nga kjo ndërtesë, është mirë që Avokatit të Popullit t'i gjendet një vend tjetër dhe gjithçka do të rregullohej, dhe jo vetëm njërën ta pavarësojmë.

Lidhur me çështjen e Avokatit të Popullit, tha se do të dëshiroja që në vlerësimet e Komisionit Evropian dhe tonat, për vetveten që i bëjmë, vërejtja jonë kryesore lidhur me Institucionin e Avokatit të Popullit, të ishte fakti që institucionet e Kosovës nuk i zbatojnë mbi 90% të rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe kjo është shumë më e dëmshme se çështja e pavarësisë fizike.

Tek fondi për integrim, tha se ju ministër përmendet dy arsye që mund të kenë çuar për mosshpenzimin e mjaftueshëm të fondeve. Ne, në mandatin e kaluar, kemi bërë një lloj vlerësimi të infrastrukturës ligjore që ka të bëjë me riintegrimin e qytetarëve në Kosovë, pasi të kthehen nga shtetet tjera. Po ashtu, kemi dalë nëpër komuna dhe ajo që ne e kemi vërejtur është se kryetarët e komunave e kanë qitur një të vërtetë se tepër pak ka bashkëpunim me qytetarët e kthyer dhe ka mos informim për të drejtat e tyre, prej aeroportit kur mbërrijnë, e deri te komuna, andaj duhet ndryshuar rregulloret në fuqi, në mënyrë që të ketë qasje më të madhe në informatat për qytetarët, që kthehen, sepse shumica dërmuese nuk dinë për të drejtat e tyre në momentin që riintegrohen, andaj edhe nuk ka shpenzim të fondit të ndarë për ta.

Në fund, lidhur me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, tha se ju e dini se ka qenë në pakon për liberalizimin të vizave. Para disa muajsh, pati ardhur në Kuvend dhe pas dy muajve që u punua në të, u tërhoq nga ana e Qeverisë, pastaj Qeveria prapë pas dy muajve që punoi në të, e solli në Kuvend, dhe pasi u punua prapë në të, Qeveria e tërhoqi. E di që ministri i Brendshëm, kur është bërë vlerësimi, është thënë se ky kriter është i plotësuar. Mirëpo, nëse ne ende e kemi ligjin e njëjtë në fuqi, pa asnjë ndryshim, a vlerësoni ju se ky mund të konsiderohet si kriter i plotësuar apo mund të na dalë ndonjë problem në ndërkohë?

Ministri sqaroi se në udhërrëfyes nuk ka pasur kërkesa specifike çfarë kanë dalë nga 8 rekomandimet e fundit, duke përfshirë edhe objektin për Avokatin e Popullit, prandaj edhe sot e kësaj dite nuk kemi zhvendosje të Gjykatës Kushtetuese, sepse nuk duam ta zgjidhim çështjen e Avokatit të Popullit e të krijojmë një problem tjetër me Gjykatën Kushtetuese. Ne po kërkojmë alternativa më të mira, në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të mbetet aty ku është, ndërsa Avokatit të Popullit t'i gjendet një objekt që i përshtatet.

Sa i përket ratifikimit të marrëveshjes si kriter, me të vërtetë është kriter monitorues dhe mosratifikimi i saj deri më tani, nuk do të pengojë në rekomandime, por është kriter i domosdoshëm dhe ratifikimi duhet të ndodhë patjetër, nëse qytetarët e Kosovës duhet të lëvizin lirshëm pa viza, dhe nëse nuk ratifikohet deri në verë, do të jetë pengesë për hyrjen e vendimit në fuqi për liberalizimin e vizave, por mendoj se koha që e kemi përpara është kohë e mjaftueshme, që dilemat e ngritura nga ky proces, të adresohen me formimin e komisionit që pritet të formohet nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, dhe pastaj nga të gjeturat e komisionit, të veprohet më tutje, por obligimet ndërshtetërore që i kemi marrë përsipër, ato duhet të zbatohen.

Sa i përket lobimit tek shtetet anëtare, tha se këtë e kam bërë gjatë të gjitha vizitave që i kam pasur gjatë gjithë vitit të kaluar dhe vizitat i bëj për këtë qëllim. Po ashtu, ne presim që pesha e vendimit në Këshill, të jetë tek shtetet më të fuqishme të BE-së, tek Gjermania dhe Franca, por tek Gjermania ka mirëkuptim në rastin tonë, për faktin se kemi shënuar progres të jashtëzakonshëm në procesin e riatdhesimit. Do të përpiqem që të bëjmë agjenda dhe vizita të përbashkëta me shtetet kyçe, sa i përket këtij procesi. Procesi është në rrugë të mbarë dhe besoj se do të përmbyllet me sukses.

Sa i përket fondit të riintegrit, tha se pajtohet me parafolësen, se edhe kur është aprovuar rregullorja në fuqi, kam pasur rezervat e mia, sepse kemi dashur që atë rregullore ta bëjmë sa më të thjeshtë për qytetarët. Duhet bërë ndryshime edhe në data, sepse secili qytetar është përfitues, pavarësisht datës kur është larguar dhe jam dakord që të rishikohet rregullorja.

Fokusi është tek riintegrimi dhe duhet të sigurohemi se nuk do të ketë fluks të ri, sepse çdo fluks i ri i emigruesve të parregullt nga Kosova, në mënyrë të pashmangshme do ta minojë procesin e liberalizimit të vizave dhe shfrytëzoj rastin që të bëjmë apel publikisht tek qytetarët, që për hir të procesit, mos ta marrin rrugën e migrimit.

Kurse lidhur me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, tha se nuk e kam idenë se kur është tërhequr dhe pse është tërhequr si dhe nuk e kam idenë se kur do të procedohet. Tanimë nuk figuron si kriter dhe konsiderohet i përmbyllur, sqarimet duhet t'i kërkonin tek ata të cilët e kanë sponsorizuar dhe tërhequr ligjin. Nuk është vështirë që secili ta dijë pse po zvarritet ky ligj, sepse shumë zyrtarë shtetërorë, duke përfshirë edhe deputetë të Republikës së Kosovës, me zbatimin ligjit, me ndryshime, pastaj do ta kenë shumë vështirë t'i mbajnë dy tre vende të punës.

Vjosa Osmani, reagoi duke thënë se nuk po më duket fer që kësaj radhe, deputetët të futen në një thes me ata që e kanë bllokuar ndryshimin e ligjit, sepse ka ndodhur e kundërta, që në këtë komision, përveç vërejtjeve të shoqërisë civile, i kemi marrë parasysh edhe vërejtjet e Komisionit Evropian dhe kemi qenë të gatshëm që t'i fusim të gjitha dhe ka pasur vullnet politik nga të gjitha partitë që të ndryshohet ligji, por nuk u mor parasysh vullneti i deputetëve.

Luljeta Veselaj- Gutaj, pyeti ministrin se pas raportit përfundimtar mos do të na dalë prapë ndonjë kriter shtesë si ai i Avokatit të Popullit. Ju përgëzoj për punën tuaj si ministri, që e keni bërë me bashkëpunëtorët. Po ashtu, ne e kemi përcjellë punën tuaj të palodhshme dhe me përpikëri, megjithatë nuk është diçka që varet nga ju dhe Komisioni ynë ose nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Ministri, në përgjigjen e tij, tha se nuk do të ketë kriter shtesë, dhe raporti që është publikuar në dhjetor, është specifikuar se është raporti i fundit. Pra, ky proces është kapitulli i fundit dhe po mbetet vetëm verifikimi i fundit në terren, si dhe dhënia e rekomandimit dhe pastaj hapat tjerë të brendshëm.

Lidhur me transferimin e mjaftueshëm të gjykatësve në Departamentin për Krime të Rënda, fillimisht kjo kërkesë ka ardhur vetëm për Departamentin për Krime të Rënda, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, por duke shikuar rritjen e lëndëve, është kërkuar që numri prej 13 gjyqtarëve të rritet dhe ky vendim është marrë nga Këshilli Gjyqësor, ndërsa tani në Departamentin për Krime të Rënda në Gjykatën Themelore të Prishtinës, punojnë 18 gjykatës, pastaj ka dalë edhe kërkesa që në departamente për krime të rënda në gjykatat e krejt Kosovës të rritet numri i gjykatësve dhe kjo është bërë me vendim të Këshillit Gjyqësor dhe në këto departamente ka numër të mjaftueshëm për t'i trajtuar dhe gjykuar me prioritet të gjitha lëndët që lidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Tek çështja e krijimit të regjistrave të hetimit, ndihmës së formës së prerë të gjykatave dhe konfiskimeve në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit, ka pasur veprime shumë konkrete dhe në raport i keni parë, se cilat janë ato veprime dhe nuk kisha dashur të lëshohem më tepër. Pra, është kriter që do të vazhdojë deri në momentin e rekomandimit. Në këtë drejtim, kemi treguar suksese të mjaftueshme.

Kryetarja falënderoi ministrin dhe theksoi se nga ky takim, si përfundim doli që edhe ne duhet të koordinohemi, së bashku me ministrin, për të realizuar vizita të përbashkëta. Si Komision, edhe ne do të duhej t'i vizitonim komunat, sa i përket fondit të integrit. Po ashtu, edhe në Bruksel, në vizitën që do ta kemi me disa personalitete mjaft të rëndësishme, mund të japim kontributin tonë gjatë lobimit.

3. Të ndryshme

Në këtë pikë u diskutua rreth organizimit të vizitës së Komisionit në Bruksel, prej dt.26 deri 29 janar 2016.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Teuta Sahatqija